



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 96
Prishtinë, më 14 shkurt 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHE 21 SHKURT 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Berat Buzhala, Vjosa Osmani, Alma Lama, Ardian Gjini, Biserka Kostiq, Myzejene Selmani, Ganimete Musliu, Haki Demolli, Liburn Aliu, ministri Besim Beqaj dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me vonesën për përgatitjen e kontratave nga Universiteti i Prishtinës për personelin akademik. Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me mospagesën e pagave për stafin akademik të angazhuar për muajt qershor, tetor, nëntor dhe dhjetor 2012 nga Universiteti i Prishtinës. Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri parashtoi pyetje për ministrin Blerand Stavileci në lidhje me aplikimin e masave mbrojtëse nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë kundër sëmundjes infektive të kafshëve si masë për parandalimin e saj.

Ministri Blerand Stavileci iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri parashtoi pyetje për ministrin Blerand Stavileci në lidhje me paraqitjen e produkteve kosovare të bujqësisë dhe ushqimit në Panairin Botëror në Berlin të Gjermanisë, si dhe rezultatet e pjesëmarrjes në këtë panair.

Ministri Blerand Stavileci iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputeti Halit Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me masat e ndërmarra nga MASHT-i për vlerësimin e përmbajtjes së Monografisë për Kosovën të hartuar dhe të botuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputeti Halit Krasniqi parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me masat e ndërmarra nga MASHT-i për vlerësimin e përmbajtjes së librave të historisë në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputetja Vjosa Osmani parashtoi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me propozimin e ministrisë që ai drejton drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për lidhjen e traktateve bilaterale të mbrojtjes dhe sigurisë me ndonjë shtet konkret.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjosa Osmani.

Deputetja Vjosa Osmani parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me përgatitjet dhe koordinimin e nevojshëm të Ministrisë së Shëndetësisë për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjosa Osmani.

Deputetja Kimete Bytyçi parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me ndarjen e mjeteve financiare për zgjerimin e hapësirave të Repartit të Gjinekologjisë nga ministria që ai drejton.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyçi.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me sasinë e parave që Qeveria e Kosovës ka marrë nga shuma e premtuar në Konferencën e Donatorëve për Kosovën, të mbajtur në Bruksel, më 11 korrik 2008, dhe në cilët sektorë janë investuar këto para.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me shkeljet konkrete që kanë bërë policët e suspenduar lidhur me ngjarjen e ndodhur më 7 janar 2013 për arrestimin e truprojave të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Ganimete Musliu parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se çfarë ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e përdorimit të insulinave të destinuara për tregun e Serbisë dhe me banderola serbe.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Aurora Bakalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me fillimin e funksionimit të Kardiokirurgjisë në QKUK nga shkurti i këtij viti.
Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputetja Aurora Bakalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me arsyet për ngecjen e funksionimit të aparaturës për Kardiologji Invazive dhe për mosfurnizimin me material për stentim koronar.
Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonat ekonomike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil,
13. Debat Parlamentar sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë,
14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
15. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 21, 24, 25, 30 janar 2013 dhe më 11 shkurt 2013.

Në vazhdim për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, tha se qëndrimi i grupit parlamentar që ai përfaqëson në lidhje me pikën nr. 14 të rendit të ditës mbetet i njëjtë nga ai i paraqitur në mbledhjen plenare të mbajtur me 6 dhjetor 2012.

Në momentin e fillimit të procedimit të kësaj pike të rendit të ditës, GP i LDK-së do ta lëshojë sallën e mbledhjeve, tha ai.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për turizmin.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj ka për qëllim rregullimin e promovimit të turizmit, regjistrimin, kërkesat e sigurisë, sistemin vlerësues, sistemin vullnetar të regjistrimit, si dhe krijimin e një kornize institucionale për zhvillimin e turizmit.

Në vazhdim, ai tha se nëpërmjet këtij projektligji përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë dhe juridikë, vendorë ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në fushën e turizmit në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë projektligj.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për turizmin.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hashim Deshishku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Aurora Bakalli, Liburn Aliu dhe Donika Kadaj-Bujupi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për turizmin.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,
Kundër -----11,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për turizmin.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për investimet e huaja.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë, duke u ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garanci fundamentale që u japin siguri investitorëve të huaj,

në mënyrë që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë, në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, standardet dhe praktikat e pranuar ndërkombëtare.

Në vazhdim, ai theksoi se nëpërmjet infrastrukturës ligjore synohet tërheqja e investitorëve të huaj që të investojnë në Kosovë, duke u ofruar kushte dhe lehtësira lidhur me investimet e tyre.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për investimet e huaja.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Albin Kurti, Bekim Haxhiu, Imri Ahmeti, Muhamet Mustafa, Hashim Dëshishku, Aurora Bakalli dhe Sadri Ferati, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për investimet e huaja. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 29,
Kundër ----- 42,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Projektligji për investimet e huaja nuk miratohet në parim, përkatësisht i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës për rihartim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për produktet e ndërtimit.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj i përcakton kërkesat teknike për përdorimin e produkteve ndërtimore, vlerësimin e konformitetit të tyre si kusht për vendosje në treg, distribuim dhe shfrytëzim në masën që i plotësojnë kërkesat themelore për objektet e ndërtimit, zbatimin e procedurave administrative, të drejtat dhe detyrimet e organeve të administratës shtetërore, personave juridikë dhe atyre fizikë.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për produktet e ndërtimit. Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-

së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për produktet e ndërtimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për produktet e ndërtimit.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve të tregut, kontrollimin e produkteve, masat kufizuese, informimin e publikut, kushtet dhe procedurat e dhënies së provimit profesional për inspektorët e tregut, bashkëpunimin me autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të vendeve të treta, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit dhe ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Sadri Ferati dhe Sali Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 2,

Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për treguesit gjeografikë.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se deri më tani fusha e pronësisë industriale është e mbuluar me ligjet përkatëse, si: Ligji për markat tregtare, Ligji për dizajn industrial dhe Ligji për patenta.

Në vazhdim, ai tha se ky projektligj i përcakton rregullat dhe mënyrën e fitimit dhe mbrojtjes së emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë të produkteve dhe e plotëson infrastrukturën ligjore nga fusha e pronësisë industriale dhe i sqaroi burimet specifike të legjislacionit të BE-së, me të cilat ky projektligj është harmonizuar.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për treguesit gjeografikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hashim Dëshiku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për treguesit gjeografikë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,

Kundër ----- 2,

Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për treguesit gjeografikë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Ministri Blerand Stavileci, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj i përcakton kërkesat e përgjithshme, të cilat duhet t'i plotësojnë produktet në mënyrë që të garantohet siguria e tyre, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, njoftimin në lidhje me produktet, të cilat janë të rrezikshme për konsumatorët, informimin e publikut, nxitjen e masave vullnetare, mbikëqyrjen ndaj përmbushjes së kërkesave të përgjithshme, si dhe miratimin e rregulloreve nga ministritë kompetente.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonat ekonomike

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për zonat ekonomike.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Armend Zemaj, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për zonat ekonomike.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Ahmet Isufi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

13. Debat Parlamentar sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, për fjalë u paraqit deputeti Adem Grabovci.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, ndërsa Kuvendi të procedojë me dy pikat tjera vijuese.

Kryetari më pas kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Grabovci.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, deklaroi se rendi i ditës duhet të procedohet sipas agjendës së miratuar. Diskutimi i plotë i z. Ismet Beqiri është dhënë në transkript.

Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deklaroi se rendi i ditës duhet të procedohet sipas agjendës së miratuar. Diskutimi i plotë i z. Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se nuk ka ndonjë arsye për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës dhe kërkoi që Kuvendi të procedojë sipas agjendës së paraparë. Diskutimi i plotë i z. Ardian Gjini është dhënë në transkript.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, e përkrahu propozimin e kryetarit të GP të PDK-së. Diskutimi i plotë i znj. Myzejene Selmani është dhënë në transkript.

Sasha Milosavleviq, në emër të GP SLS, e përkrahu propozimin e kryetarit të GP të PDK-së. Diskutimi i plotë i z. Sasha Milosavleviq është dhënë në transkript.

Lidhur me propozimin e deputetit Adem Grabovci, diskutoi edhe deputeti Bekim Haxhiu, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Adem Grabovci që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, ndërsa Kuvendi të procedojë me dy pikat tjera vijuese.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 40,
Kundër ----- 34,
Abstenime ----- 2.

Kryetari Konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Adem Grabovci që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, ndërsa Kuvendi të procedojë me dy pikat tjera vijuese.

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryetari tha se në mbledhjen plenare të mbajtur me 6 dhjetor 2012, për këtë pikë të rendit të ditës ishin deklaruar kryetarët apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në mbledhjen plenare të lartpërmendur, Kuvendi e miratoi mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për njëhën nga mbledhjet e ardhshme dhe Qeveria sa më shpejt t'i plotësojë biografitë e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në vazhdim, kryetari theksoi se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i ka shqyrtuar biografitë e të propozuarve për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Ai i ftoi deputetët për miratimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Diskutimi i plotë i z. Zenun Pajaziti është dhënë në transkript.

Ismet Beqiri tha se Grupi Parlamentar i LDK-së, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës qëndrimin e vet e ka deklaruar në punimet e paradites së kësaj mbledhjeje plenare. Diskutimi i plotë i z. Ismet Beqiri është dhënë në transkript.

Më pas GP i LDK-së e lëshoi sallën e mbledhjeve.

Visar Ymeri tha se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” konsideron se disa nga të propozuarit për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk i plotësojnë kriteret profesionale për t’u emëruar në këtë Bord. Diskutimi i plotë i z. Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Më pas GP i Lëvizjes “Vetëvendosjes” e lëshoi sallën e mbledhjeve.

Ardian Gjini tha se edhe pse të propozuarit në këtë bord janë të propozuar politikë, grupi që ai përfaqëson do të jetë i pranishëm në sallën e mbledhjeve. Diskutimi i plotë i z. Ardian Gjini është dhënë në transkript.

Myzejene Selmani tha se grupi që ajo e përfaqëson mbështet raportin me rekomandime të Komisionit funksional lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Diskutimi i plotë i znj. Myzejene Selmani është dhënë në transkript.

Sasha Milosavleviq tha se Grupi Parlamentar SLS e mbështet raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Diskutimi i plotë i z. Sasha Milosavleviq është dhënë në transkript.

Në vazhdim kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 55 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin e pikave të rendit të ditës.

Ai tha se për vazhdimin e mbledhjes plenare deputetët do të njoftohen me kohë.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 16:40 minuta.

* * *

21 shkurt 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 14 shkurt 2013

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Xhavit Haliti dhe Petar Miletiq.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 14 shkurt 2013.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

13. Debat Parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Kuvendi në mbledhjen plenare të mbajtur më 14 shkurt 2013 e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

Ai më tej theksoi se deputetët Bekim Haxhiu e Vjollca Krasniqi dhe grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë.

Në vazhdim, kryetari e ftoi deputetin Bekim Haxhiu që në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Bekim Haxhiu fillimisht tha se iniciativa për këtë debat parlamentar është e imja, bashkë me deputeten Vjollca Krasniqi.

Në vazhdim, ai theksoi se prej më shumë se dy dekadave, e mbi 13 vjet prej përfundimit të luftës, dhe 5 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sporti kosovar vazhdon të mbetet i izoluar dhe i marginalizuar, ndërsa ky debat parlamentar është ftuar me qëllim për të diskutuar për gjendjen në të cilën ndodhet sporti në Kosovë, për veprimet që duhet ndërmarrë për zhvillimin e tij dhe që Kuvendi i Kosovës me anë të këtij debati ta japë kontributin për thyerjen e izolimit shumëvjeçar të sportit kosovar.

Ai më tej foli rreth vendimit të FIFA-s dhe për modalitetet e papranueshme politike që ajo ia ka vendosur Federatës së Futbollit të Kosovës për zhvillimin e ndeshjeve miqësore dhe për problemet e njëjta me të cilat janë duke u përballur shumica e federatave në vend, bashkë me Komitetin Olimpik. Ky izolim që po i bëhet sportit kosovar është shkelje edhe e konventave ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, konstatoi ai.

Ai më pas u fokusua në sukseset dhe vështirësitë e shumë sportistëve kosovarë në arenën ndërkombëtare, për të cilët tha se janë ambasadorë të vendit tonë dhe e shtroi nevojën e krijimit të një platforme për zhvillimin e sportit dhe thyerjen e izolimit, si dhe të formimit të një komiteti shtetëror për zhvillimin e sportit dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Deputeti Haxhiu në fund i ftoi të gjithë deputetët që ta japin kontributin për plotësimin e rekomandimeve dhe në fund ato të votohen.

Diskutimi i deputetit Bekim Haxhiu është dhënë i plotë në transkript.

Vjollca Krasniqi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha se në Kuvend rrallëherë është trajtuar njëra nga brengat e shoqërisë sonë, në veçanti të rinisë, siç është sporti. Nuk e di pse ky segment aq vital nuk ka trajtim më serioz dhe më fundamental, kur dihet se në Kosovë ka një numër imponant aktivistësh, mijëra të rinj dhe të reja i zhvillojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të organizuar.

Janë diku afro 30 federata të ndara në dy grupe të sporteve olimpike dhe joolimpike, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe e zhvillojnë sportin ndër ne dhe diku afro 350 klube të sporteve të ndryshme, ndërsa ne ngurojmë dhe hezitojmë të merremi me çështjet e tyre.

Në vazhdim, ajo theksoi se federatat e sportit janë në varësi të plotë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa shuma e mjeteve, sado e vogël që është, duhet t'u jepet në menaxhim apo në administrim në fillim të vitit, varësisht nga kriteret dhe programet që ofrojnë ato, e jo të vepohet si deri më tani.

Më pas, ajo foli edhe për domosdoshmërinë e miratimit të Ligjit për sponsorim, për gjendjen në infrastrukturën sportive në përgjithësi, për definimin e pronësisë së objekteve sportive, për Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, dhe aspekte tjera që lidhen me fushën e sportit në Kosovë, si dhe për shembujt në regjion të cilët tregojnë se një opsion shumë konstruktiv do të ishte dhënia me koncesion e objekteve sportive për afat 25 deri 30 vjet, nën kushtet e përcaktuara më mirë.

Ajo në fund foli edhe për idenë për unifikimin e ligës kombëtare të futbollit, të iniciuar nga kryeministri i Shqipërisë.

Diskutimi i deputetes Vjollca Krasniqi është dhënë i plotë në transkript.

Albana Gashi, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se për 11 vjet, sa Kosova ka Qeveri e Parlament, sporti asnjëherë nuk ka qenë as prioritet, e as ndër prioritetet e kësaj Qeverie. Për ta vërtetuar këtë, është organizuar ky debat i sotëm, i pari që i kushtohet sportit.

Në vazhdim, ajo tha se Kosova i ka 10 federata të ndërkombëtarizuara, 5 me të drejta të plota e 5 më të drejta të kufizuara, por situata në ato federata nuk dallon shumë nga ato që nuk janë të ndërkombëtarizuara.

Procesi i ndërkombëtarizimit është i lidhur ngushtë me njohjen e shtetësisë së Kosovës. Shumë federata botërore e kanë kusht kryesor në statutin e tyre që federata që aplikon për pranim duhet të vijë nga një shtet i njohur nga OKB-ja. E Kosova nuk është e njohur, e për pasojë po e vuan edhe izolimin në sport.

Më pas, ajo u fokusua në gjendjen e infrastrukturës sportive në Kosovë, në ndërtimin e palestrave sportive, në projektin për ndërtimin e gjashtë fushave ndihmëse nëpër 6 qendra të Kosovës, për mundësinë e ndarjes në formë page, apo burse për sportistët e Republikës së Kosovës.

Diskutimi i deputetes Albana Gashi është dhënë i plotë në transkript.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht e shtroi nevojën e definimit të temës së debatit të sotëm nëse është debati për sportin në Kosovë, apo për ndërkombëtarizimin e sportit të Kosovë.

E di që janë të lidhura këto ndërmjet veti, por nëse duam të punojmë diçka, nëse duam me të vërtetë ta bëjmë një punë në lidhje me sportin, duhet t'i ndajmë. Ne nuk kemi problem esencial me ndërkombëtarizimin e sportit. Ne kemi problem esencial me sportin në Kosovë. Kemi problem esencial me atë se sa të rinj me të vërtetë merren me aktivitete sportive.

Në vazhdim, ai u fokusua në gjendjen faktike të sportit në Kosovë dhe përmendi disa nga problemet, që kanë të bëjnë me udhëheqjen e klubeve sportive nga kryetarët e komunave dhe politikanët, gjendjen e objekteve sportive, çështjet financiare të klubeve sportive etj.

Diskutimi i deputetit Ardian Gjini është dhënë i plotë në transkript.

Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se gjendja e sportit në Kosovë nuk është e kënaqshme.

Duhet sa më parë të miratohet Ligji për sponsorimin, i cili edhe nga vetë federatat konsiderohet si çelës i zgjidhjes së shumë problemeve.

Gjithashtu, Kuvendi dhe Qeveria në takime ndërkombëtare duhet ta diskutojnë problematikën e sportit kosovar, theksoi ai.

Grupi parlamentar që ai përfaqëson do t'i mbështesë rekomandimet në fund të këtij debati, tha ai.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, Afërdita Berisha-Shaqiri, Afrim Kasolli, Time Kadrijaj, Aurora Bakalli, Blerta Deliu-Kodra, Lutfi Haziri, Xhevdet Neziraj, Ganimete Musliu, Haki Demolli, Shaip Muja, Ismet Beqiri, Sabri Hamiti, Burim Ramadani, Boban Todoroviq, Halit Krasniqi, Lirije Kajtazi, Mursel Halili, Valbona Dibra, Salih Morina, Zenun Pajaziti, Nazane Breca, Sadri Ferati, Arben Gashi, Jakup Krasniqi dhe ministri Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Bekim Haxhiu, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit e paraqiti tekstin e rekomandimeve të harmonizuara, për miratim nga Kuvendi.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e propozuara nga deputeti Bekim Haxhiu.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 16,
Abstenime ----- 4.

Kryetari Konstatoi se Kuvendi i nxori këto:

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës i rekomandon Qeverinë së Kosovës dhe Komisionit përkatës parlamentar që në afat sa më të shkurtër kohor ta përgatisë për miratim një pako ligjesh, që do të ndikojnë në zhvillimin e sportit dhe ndaljen e dukurive negative në sport, si: Projektligjin për sponsorim, Projektligjin për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre dhe Projektligjin kundër huliganizmit dhe dukurive tjera negative në sport;
2. Obligohet Qeveria e Kosovës që ta përkrahë ndërkombëtarizimin dhe anëtarësimin e sportit kosovar në mekanizmat ndërkombëtarë;
3. Obligohet Diplomacia kosovare që në të gjitha takimet ndërkombëtare ta diskutojë problematikën e sportit të Kosovës dhe ta mbështesë ndërkombëtarizimin e tij;
4. Kuvendi i Kosovës obligohet që t'u dërgoi shkresë zyrtare të gjitha shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës, që ato të ndikojnë te përfaqësuesit e federatave të tyre për mbështetje dhe pranim të sportit kosovar dhe
5. Ministria e Sportit ta hartojë një strategji për masivizim të sportit, duke filluar nga ai shkollor.

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi Xhavit Haliti në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se, në mbledhjen plenare, të mbajtur me 14 shkurt 2013, pas paraqitjes së fjalës nga kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi nuk kishte kuorum për procedimin e mëtejshëm të kësaj pike të rendit të ditës.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64deputetë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 50,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

I. Blerim Rexha emërohet kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me mandat tre (3) vjeçar.

II. Anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me mandat dy (2) vjeçar emërohen:

1. Maja Milanoviq, anëtare;
2. Haxhi Arifi, anëtar;
3. Dardane Peja, anëtare dhe
4. Skender Komoni, anëtar.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

15. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar deputetin Shaip Muja për anëtar në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Berat Buzhala.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kuvendi miratoi propozimin e lartshënuar. Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Shaip Muja emërohet anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Berat Buzhala.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*